



**KONTRATA SOCIALE
VAU I DEJËS**

**RAPORT MBI
MONITORIMIN E
PËRMBUSHJES SË
PRIORITETEVE
SHTATOR 2022-SHTATOR 2023**

RAPORTI I TRETË I MONITORIMIT

**PËRGATITUR NGA:
QENDRA "HAPA TË LEHTË"**

POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Raport mbi Monitorimin e Përbushjes së Prioriteteve të Kontratës Sociale

Bashkia Vau Dejës

Shtator 2022 – Shtator 2023

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të kontratës sociale për periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023, referuar edhe rezultateve të monitorimit të një viti më parë.

Përgatiti raportin: Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë”

Tabela Përmbledhëse

FALENDERIME.....	3
HYRJE	4
METODOLOGJIA.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
GJETJE	8
KONTRATA SOCIALE	9
GJETJET NGA MONITORIMI DHE INFORMACIONI I BASHKISË VAU DEJËS.....	10
<i>PRIORITETI 1.....</i>	<i>10</i>
<i>PRIORITETI 2.....</i>	<i>11</i>
<i>PRIORITETI 3.....</i>	<i>12</i>
<i>PRIORITETI 4.....</i>	<i>13</i>
<i>PRIORITETI 5.....</i>	<i>14</i>
<i>PRIORITETI 6.....</i>	<i>14</i>
<i>PRIORITETI 7.....</i>	<i>16</i>
<i>PRIORITETI 8.....</i>	<i>16</i>
MONITORIM I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS	18
PËRFUNDIME NGA VLERËSIMI I KB VAU DEJËS.....	21
VLERËSIM I THELLUAR DHE PËRFUNDIME	22
REFERENCA	

Falenderime

Puna për realizimin e këtij dokumenti është e madhe dhe e shtrirë në kohë.

Ky raport nuk do të mund të realizohet pa një bashkëpunim të ngushtë midis Qendrës së Gruas “Hapa të Lehtë”, projektit POP, përfaqësuesve të qeverisjes vendore dhe Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

Për realizimin e këtij raporti vlen për t’u përgëzuar vullneti për të bashkëpunuar dhe koordinuar punët, ndërhyrjet dhe informimin.

Për këtë arsye, falenderimi i parë dhe shumë i rëndësishëm është për Bashkinë dhe Këshillin e Bashkisë Vau Dejës. Falenderim të veçantë për komunitetin e Bashkisë Vau Dejës e në veçanti gratë dhe vajzat aktive të kësaj Bashkie dhe organizatat e shoqërisë civile të bashkisë, të cilët pranuan të bëhen pjesë e intervistave/fokus grupeve tona, të rinjtë, mësuesit, grupe të ndryshme të interesit.

Falenderit për punën e bërë për të monitoruar të gjithë aktivitetin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës dhe mbikqyrur progresin e premtimeve të Kontratës Sociale POP – 2021 nga ana e Bashkisë Vau Dejës.

Gjithashtu, një falenderim i veçantë shkon për Olof Palme International Center dhe NED – National Endowment for Democracy për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë
- Qendra "Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile", Durrës
- Qendra Rinore Vlorë • Qendra "Epoka e Re", Fier
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë
- Qendra Rinore për Progres, Kukës
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës
- Tjetër Vizion, Elbasan
- Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë”, Korçë

Gjatë periudhës Shtator 2021-2022 për të tretin vit me rradhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Ky është viti i katërt i monitorimit të punës së pushtetit vendor për përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve dhe përmbushjen e Kontratës Sociale. Ndërsa për Bashkinë Vau Dejës ky është viti i tretë i monitorimit. Kontrata Sociale në Bashkinë Vau Dejës përmban 8 prioritete që banorët e Bashkisë Vau Dejës identifikuan në zgjedhjet lokale të 2021. Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë”, synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetarë në funksion të përmirësimit të demokracisë vendore, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, dhe në zgjedhjet vendore të 2023, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë” mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës vendore dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor.

Në Bashkinë Vau Dejës, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin Bashkiak përgjegjës për adresimin e tyre.

Faza e parë e kësaj nisme konsistoi në konsolidimin e saj me Qeverisjen vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të saj me aktorët kryesorë vendore.

Kjo periudhë përfshin procesin e monitorimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, të zbatimit të prioriteteve të kontratës sociale, të forcimit të marrëdhënieve midis qytetarëve, POP dhe aktorëve të tjerë në shoqëri. Pjesë e rëndësishme e saj ishte raportimi dhe veshja me përgjegjësi e drejtuesve në nivelin lokal për të përmbushur kontratën sociale. Raporti i vitit të parë monitorues¹ dhe raporti i vitit të dytë² është ndarë gjerësisht me përfaqësues të bashkisë Vau Dejës si edhe me qytetarët duke analizuar arritjet, por edhe punën që duhet bërë për përmbushjen e atyre prioriteteve që janë adresuar pak, ose aspak dhe kanë nevojë për një vëmendje më të shtuar të pushtetit vendor.

Për të mbërritur në vitin e tretë të monitorimit, gjatë vitit 2023, Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë” vijoi punën, duke monitoruar dhe bashkëpunuar mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023.

Gjatë vitit të tretë të monitorimit Organizata pati si qëllim:

- Të monitorojë veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë veprimtarinë e Këshillit Bashkiak;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies;
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

¹ https://popnetwork.al/vau-i-dejes_raporti-monitorues-gusht-dhjetor-2021-kontrata-sociale/

² https://popnetwork.al/vau-i-dejes_raporti-monitorues-i-kontrates-sociale-2022/

Metodologjia

Për realizimin e këtij raporti, Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë”, pjesë e rrjetit POP, u bazua në informacione dhe fakte të grumbulluara, nëpërmjet:

- ❖ Takimeve të drejtëpërdrejta me Qytetarë

Monitorimit

- ❖ Bashkisë
- ❖ Këshillit Bashkiak
- ❖ Terrenit

Për të realizuar raportin, Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë”, anëtare e rrjetit POP u bazua në hapat e mëposhtëm:

- U monitorua puna e Bashkisë Vau Dejës dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023;
- U organizuan takime me Kryetarin e Bashkisë z. Kristjan Shkreli, Përgjegjësen e Shërbimeve Sociale znj. Cuka Babani, Specialistin e Shërbimeve Publike i cili mbulonte çështjen e transportit publik, Drejtoreshën e Finances dhe Buxhetit znj. Elsa Tanushi mbi ecurinë e punës sa i përket përmbushjes së prioriteteve të Kontratës Sociale 2021-2023 dhe 2023-2027.
- U realizuan fokus - grupe me anëtarë të komunitetit në 3³ Njësi Administrative të Bashkisë Vau Dejës, me pjesëmarrës nga grupe të ndryshme aktive (komunitet i larmishëm), të cilët kanë qenë aktiv në aktivitetet e mëparshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të Kontratës Sociale si edhe në monitorimin e saj gjatë vitit të parë dhe të dytë;
- U monitorua në vazhdim puna e Këshillit Bashkiak Vau Dejës, mbledhjet e organizuara;
- U monitoruan vendimet e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës;
- U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak mbi masat e marra nga vetë bashkia, në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target – grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak;
- U analizua dhe monitorua buxheti i bashkisë për vitet 2022 – 2023 si dhe shpenzimet respektive bazuar në open-data.
- U monitoruan dhe analizuan vendimet e KB Vau Dejës që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale bazuar në punën e rrjetit POP, apo edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit:

³ Njësi Administrative Laç Vau Dejës, Hajmel, Bushat

- ✓ Parashikime të mëhershme në buxhet;
- ✓ Ndikime të tjera (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare).

Hapat e ndjekur

- ✓ Takime të drejtëpërdrejta me përfaqësues të Bashkisë Vau Dejës për informacione specifike, kryesisht për çështjet e paadresuara ende dhe ato pjesërisht të adresuara.
- ✓ Paralel me këto takime u zhvilluan edhe fokus grupet me qytetarët dhe grupet e interesit që lidhen direkt ose indirekt me përmbushjen/mospërmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.
- ✓ Monitorimi si hap i ndjekur në vetvete u realizua në këto mënyra:
 - Monitorim i mbledhjeve të këshillit bashkiak (gjatë gjithë periudhës Shtator 2022 – Shtator 2023).
 - Monitorim i <https://www.vaudejes.gov.al/>, faqja zyrtare e bashkisë Vau Dejës
 - Monitorim faktik për çdo prioritet (gjatë periudhës së grumbullimit të informacioneve dhe takimeve me qytetarët dhe grupet e interesit).
 - Monitorim i implementimit të buxhetit/buxhetit afatmesëm, PBA, etj.
 - Monitorim dhe analizim i mediave audio vizive dhe on line, sipas fushave specifike. Sjellja dhe qasja e tyre.
 - Monitorim dhe analizë e detajuar e buxhetit mbi ecurinë buxhetore të realizimit të Kontratës Sociale Shtator 2022 – Shtator 2023.

Krahas monitorimit është punuar edhe në aspektin formues, nxitës dhe lobues të komunitetit në veçanti grave dhe vajzave duke iu drejtuar shkresa /ankesa Kryetarit dhe Këshillit Bashkiak për adresimin me prioritet të pikave të Kontratës Sociale.

Gjatë periudhës Shtator 2022 – Shtator 2023 Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë”, bazuar në objektivat e projektit, kishte si qëllim kryesor ndjekjen dhe nxitjen e progresit të përmbushjes së Kontratës Sociale.

Nëpërmjet saj synonte edhe objektivat specifike si:

- Fuqizimin e ndikimit të zërit qytetar, OSHC-ve për të monitoruar dhe advokuar pranë Bashkisë Vau Dejës për zbatimin e kornizës ligjore, si dhe përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.
- Forcimin e rrjetit POP nëpërmjet bashkëpunimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme për ta shtrirë impaktin edhe në bashki të tjera, jashtë territorit të veprimtarisë.
- Forcimin e marrëdhënieve midis qytetarëve, POP dhe aktorëve të tjerë në shoqëri, realizuar kjo nëpërmjet kontakteve të shumta dhe prezencës së vazhdueshme në komunitet.
- Monitorimi, raportimi dhe nxitja e drejtuesve në nivel vendor për të përmbushur Kontratën Sociale në Bashkinë Vau Dejës.

Aktorët dhe target grupet e përfshira në proces:

- ✚ Bashkia Vau Dejës dhe Këshilli Bashkiak Vau Dejës;
- ✚ Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës;
- ✚ Media
- ✚ Organizatat e Shoqërisë Civile si aleatë në këtë proces;
- ✚ Gratë, të rinjtë dhe qytetarët.

Kjo nismë mbështetet nga Olof Palme International Center, me fonde të Qeverisë Suedeze si dhe nga National Endowment for Democracy.

Përmbledhje Ekzekutive

Rritja e ndikimit të qytetarëve, të rinjve, grupeve të interesit dhe forcimi i marrëdhënieve mes tyre dhe qeverisjes në nivel vendor, duke përdorur si mekanizëm bashkëpunimin, gjithashtu për përmbushjen e Kontratës Sociale, ka qenë fokusi i punës së projektit POP gjatë periudhës Shtator 2022 – Shtator 2023 në Bashkinë Vau Dejës.

- ❖ Fillimi i punës për ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Vendor Rinor.
- ❖ Monitorim i vazhdueshëm i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, me një qasje të re të frekuentueshmërisë së tij nga shoqëria civile dhe gra aktive.
- ❖ Monitorim i punës së qeverisjes vendore në të gjithë territorin e Bashkisë për të ndjekur ecurinë e përmbushjes së prioriteteve të Kontratës Sociale.
- ❖ Bashkëpunim, koordinim dhe ndërveprim mes Qendrës së Gruas Hapa të Lehtë, të grave, vajzave dhe qeverisjes vendore duke nxitur forcimin e marrëdhënieve mes tyre.
- ❖ Prezencë e kënaqshme në takimet, organizimet dhe konsultimet që Bashkia Vau Dejës ka iniciuar gjatë periudhës Shtator 2022 – Shtator 2023, duke luajtur një rol aktiv në pjesëmarrje dhe nxitje të prezencës qytetare në to, me qëllim rritjen e ndërveprimit mes trinomit qytetarë – OSHC – qeverisje vendore.

✚ Gjetjet:

- Gjatë periudhës Shtator 2022 – Shtator 2023, Këshilli Bashkiak Vau Dejës ka marrë 115 vendime, 43 vendime Shtator – Dhjetor 2022 dhe 72 për periudhën Janar – Shtator 2023 të cilat kanë ndikim direkt ose indirekt në përmbushjen e pikave të Kontratës Sociale 2021.
- Gjatë periudhës Shtator 2022 – Shtator 2023, mbledhjet e Këshillit Bashkiak Vau-Dejës janë zhvilluar në sallën e mbledhjeve të KB Vau Dejës.
- Gjatë periudhës Shtator 2022 – Shtator 2023 janë realizuar gjithsej 9 dëgjesa publike ku dy janë konsultime për buxhetin, një është për hapjen e një rruge të re në fshatin Nënshat dhe 6 janë për dhënie në përdorim të kullotave, ngastrave etj.
- Bashkia përdor disa mënyra për të shpërndarë njoftimet me interes publik: online dhe shpallje në vende me akses të gjerë.
- Mënyrat më efikase që Bashkia Vau Dejës përdor për njoftimet e qytetarëve dhe grupeve të interesit janë: Publikimet online në rrjetet sociale dhe në mënyrë të

drejtëpërdrejtë nëpërmjet kryepleqve të fshatrave, administratorëve, apo njerëzve influentë.





- Qytetarët kanë shtuar rastet e shërbimit të kërkesë – ankesës në zyrën One Stop Shop nëpërmjet rrugës zyrtare edhe pse mbetet ende funksionale edhe mënyra online (email/fb), apo takimet e drejtëpërdrejta me personat përgjegjës ose kryetarin e bashkisë.
- Gjatë periudhës Shtator 2022 – Shtator 2023 është ndërhyrë në disa rrugë dhe godina.
- Mbetet ende sfidë sigurimi i financimit për ngritjen e një çerdhe/kopshti me drekë, rikonstruksioni i Qendrës Kulturore si dhe sigurimi transportit publik.
- Bashkia Vau Dejës ka filluar punën për hartimin, finalizimin e projektit për rikonstruksionin e Qendrës Kulturore për ta prezantuar pranë qeverisë qendore apo donatorëve.

Kontrata Sociale

Nisma e rrjetit POP synon të rrisë debatin publik dhe informacionin tek qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Për të arritur këtë qëllim është hartuar Kontrata Sociale për të gjitha bashkitë, ku organizatat e rrjetit operojnë, e cila është firmosur nga Kryetari i Bashkisë.

Kontrata Sociale është një dokument i hartuar me prioritetet e qytetarëve nga takime, fokus grupe dhe forume të organizuara gjatë periudhës parazgjedhore 2021.

Prioritetet e komunitetit bazohen në katër shtylla kryesore:

-  Shërbimet Publike
-  Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja
-  Zhvillimi Ekonomik Vendor
-  Dimensioni Social në Nivel Vendor.

Kontratave Sociale nuk janë thjeshtë një premtim i shkruar, por një angazhim për kryetarët e zgjedhur për të përmbushur këto prioritete brenda katër vjeçarit të mandatit të tyre. Kontrata Sociale e Bashkisë Vau Dejës u formalizua në Shtator 2021, me dakortësimin/firmosjen e saj nga: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës Z. Mark Babani dhe Presidentes së Qendres së Gruas Hapa të Lehtë znj. Denada Shpuza. Gjithashtu gjate forumit publik të realizuar në kuadër të zgjedhjeve vendore 2023-2027 është nënshkruar Kontrata Sociale me kandidatin për Kryetar Bashkie z. Kristian Shkreli⁴, aktualisht Kryetar i Bashkisë Vau Dejës.

Nëpërmjet këtyre dy Kontratave, Bashkia angazhohet në realizimin e disa çështjeve që për komunitetin dhe kryesisht për gratë janë prioritare. Puna për përgatitjen e tyre nisi muaj më parë. Përpara përpilimit të kësaj Kontrate Sociale u arrit grumbullimi i mendimit dhe prioriteteve të qytetarëve/të rinjve. U realizuan disa fokus grupe dhe u studiuat gjithë situata në territorin e

⁴ <https://popnetwork.al/8005-2/>

Bashkisë Vau Dejës, shpërndarë në problematika e shërbime reale, marrëdhëniet e ndërveprimet komunitet/gra, të rinj, qeverisje vendore etj.

Informacioni dhe rezultatet e grumbulluara nga këto zhvillime, u ndanë dhe u selektuan në bazë prioritesh nga të cilat u zgjodhën po nga gratë, të rinjtë dhe komuniteti, nëpërmjet procesit me fokus grupe, ato më të rëndësishme dhe emergjente të cilat ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre/komunitetit. Prioritetet e përzgjedhura nga të komuniteti i Bashkisë Vau Dejës, janë të shtrira në 8 shtylla kryesore, si më poshtë vijon për Kontratën Sociale 2021-2023⁵ dhe 7 shtylla për Kontratën Sociale 2023-2027⁶, nga të cilat 5 janë të ngjashme me Kontratën Sociale të vitit 2021-2023.

Situata e Prioriteteve

Prioritete e Kontratës Sociale 2021-2023

Prioriteti nr.1

Transporti Publik⁷.

Pavarësisht se mungesa e këtij shërbimi ndikon drejtpërsëdrejti në të gjithë komunitetin, ai më së shumti ndikon në jetën socio ekonomike të grave dhe vajzave. Gratë dhe vajzat e kësaj bashkie për shkak të mentalitetit janë të detyruara, të lëvizin të shoqëruar nga një familjar tjetër, për shkak se duke mos patur një vendqëndrim dhe orar nisje, janë të detyruara të presin në rrugë deri kur të kalojë ndonjë makinë që bën transport, e cila bën të mundur lëvizjen e tyre në drejtim të destinacionit që duan të shkojnë. Krahas koston sociale, kjo shoqërohet edhe me kosto ekonomike sepse do te paguhen 2 bileta.

Prandaj për sa më sipër kërkohet:

- Sigurimi i transportit publik me orare, vend-nisje dhe vend-mbërritje të mirë përcaktuara që të mbulojnë të gjitha njësitë administrative dhe një kohështrirje përgjatë gjithë ditës.
- Tarifat e transportit të jenë jo vetëm sipas largësisë por edhe kategorive sociale.

⁵ Kontrata Sociale 2021-2023 Bashkia Vau Dejës <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-vau-i-dejes-2/>

⁶ Kontrata Sociale 2023-2027 Bashkia Vau Dejës <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-2023-2027-pop-vau-i-dejes/>

⁷ Ky prioritet gjendet në të dy Kontratat Sociale, atë të vitit 2021-2023 dhe të vitit 2023-2027, në këtë të fundit ky prioritet mban nr.4

[file:///C:/Users/User/Downloads/BASHKIA-VAU-DEJES-Prioritetet-A3-Kontrata-OK%20\(3\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/BASHKIA-VAU-DEJES-Prioritetet-A3-Kontrata-OK%20(3).pdf), prioriteti nr.1
<https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2023/04/Kontrata-Sociale-Vau-i-Dejes.pdf>, prioriteti nr.4

- Publikimi i orareve të nisjes, të mbërritjes dhe respektimi i tyre.

Në takimin e realizuar me Kryetarin aktual të Bashkisë Vau Dejës, z. Shkreli, rezultoi se; Kryetari me marrjen e detyrës ka ftuar në një takim operatorët ekonomik për ti kërkuar ofrimin e shërbimit për disa njësi administrative me orare dhe vendndodhje të caktuara.

Nga ky takim rezultoi se: ky shërbim nuk paraqet interes për asnjë operator ekonomik për shkak të numrit të ulët të qytetarëve që kërkojnë marrjen e këtij shërbimi.

Përfundim në lidhje me rezultatin nr.1 Kjo problematikë nuk është adresuar aspak për zgjidhje nga Bashkia as në Kontratën Sociale të vitit 2021-2023 dhe as në atë të vitit 2023-2027, pavarësisht përpjekjeve për adresimin e saj për zgjidhje.

Prioriteti nr.2 **Kopshte /Çerdhe ⁸**

Mungesa e këtij shërbimi ndikon më së shumti gratë dhe nënat e reja të cilat për shkak të kësaj mungese e kanë të pamundur të punësohen dhe të krijojnë pavarësi ekonomike.

Prandaj, për sa më sipër kërkohet:

- Bashkia duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për ngritjen e një çerdhe /kopshti me drekë. Kjo duhet të bëhet me tarifa të përbalueshme për të gjitha familjet. Nga kjo tarifë, duhet me patjetër të përjashtohen familjet me ndihmë ekonomike apo nënat kryefamiljare.

Përmirësimi i infrastrukturës dhe ngrohjes së shkollave në fshatrat Pistull dhe Paçram në njësinë administrative Hajmel.

- Ndërtimi i terreneve sportive në njësinë administrative Hajmel.
- Rikonstruksioni i shkollës dhe ndërtimi i palestrës në njësinë administrative Mjedë
- Kopshtet me drekë dhe çerdhet mungojnë në të gjithë territorin e bashkisë dhe kërkohet adresimi me prioritet i kësaj çështjeje.

Grupi i grave aktiviste dhe pjesëmarrëse në aktivitetet e realizuara nga Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë” për hartimin e Kontratave Sociale 2021-2023 dhe 2023-2027, i kërkuan anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës të firmosin një kërkesë /ankesë për ngritjen e një çerdhe/kopshti me drekë. Kjo shkresë u inicua nga grupi i grave aktiviste dhe vazhdoi me mbështetjen e znj. Zyberi anëtarë e Këshillit Bashkiak Vau Dejës dhe themeluese e shoqatës Artizan-et e Vau Dejës. Kjo shkresë u dorëzua zyrtarisht në protokollin e Bashkisë Vau Dejës.

⁸ kete prioritet e gjejmë edhe tek kontrata sociale e vitit 2023-2027 [file:///C:/Users/User/Downloads/Kontrata-Sociale-Vau-i-Dejes%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/Kontrata-Sociale-Vau-i-Dejes%20(1).pdf)

Përfundim në lidhje me prioritetin nr.2.

Nga të gjitha aktivitetet e realizuar nga QGHL me qëllim monitorimin e përmbushjes së prioritetëve të Kontratës Sociale 2021-2023 dhe 2023-2027, rezulton se kemi një përmirësim të infrastrukturës në disa godina të arsimit parauniversitar, por nuk kemi ngritjen e një çerdhe /kopshti me drekë.

Situata paraqitet e njëjtë edhe pas marrjes së detyrës nga kryetari aktual z. Shkreli.

Mund të themi që ky prioritet është adresuar në masën 50%, pasi kemi rikonstrukcionin e shkollës së mesme të bashkuar Mjedë, palestres dhe mobilimin me pajisje. Për realizimin e këtij rikonstrukcioni është lidhur kontrata me vlerë 99,286,112.00, ndërsa mobilimi me pajisje i kësaj shkolle kap vlerën 1,731,900.00. Nga monitorimi rezulton se nuk është adresuar aspak për zgjidhje ngritja e çerdes/kopshtit me drekë, pavarësisht se ky prioritet është futur në listën e prioritetëve të Bashkisë.

Nga monitorimi i këtij prioriteti rezulton se kemi një vëmendje të shtuar përse i përket furnizimit me dru në shkolla, duke lidhur një kontratë me vlerën 3,360,000 por në disa shkolla vazhdon ngrohja me energji elektrike.

Mund të themi se ky prioritet është përmbushur në masën 60%.

Prioriteti nr.3⁹

Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet

Furnizimi me ujë të pijshëm, me orare të caktuara apo jashtë cilësisë ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në jetën e grave dhe vajzave të cilat janë më së shumti në shtëpi dhe duhet të merren me gatimin, pastrimin e shtëpisë, rrobave dhe me larjen e fëmijëve, etj.

Prandaj, për sa më sipër kërkohet:

- Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit në të gjitha fshatrat e të dy njësive administrative Laç -Vau Dejës dhe Hajmel.

Me Kontratën Sociale të vitit 2023-2027 kemi kërkesë për shtim të furnizimit me ujë të pijshëm edhe në njësinë administrative Bushat.

a. Uji i Pijshëm

- Kërkohet furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë në të tre njësitë administrative;
- Klorinimi në mënyrë të rregullt;
- Oraret gjatë stinës së verës duhet të jenë më të zgjatura;

⁹ Këtë prioritet e gjejmë të shkruar edhe në kontratën sociale të vitit 2023-2027, renditur si prioriteti nr.7, konkretisht [file:///C:/Users/User/Downloads/Kontrata-Sociale-Vau-i-Dejes%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/Kontrata-Sociale-Vau-i-Dejes%20(1).pdf)

- Nevojitet më shumë rregullsi në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit në të gjithë Bashkinë;
- b. Kanalizimet
- Sistemi i kanalizimeve të ujrave të zeza pranë shkollës SHMB Imzot Lucian Avgostini

Përfundim në lidhje me prioritetin nr.3. Nga monitorimi i Kontratës Sociale rezulton se kemi përmirësim të situatës së furnizimit me ujë të pijshëm në njësinë administrative Bushat, dhe Laç Vau Dejës, nga ku rezulton se në këto dy njësi kemi një përmirësim të furnizimit në masën **80 % me ujë të pijshëm**, por situata nuk paraqitet e njëjtë në njësinë administrative Hajmel ku furnizimi me ujë të pijshëm është me orare të reduktuara. Prandaj mund të themi se kemi adresim në masë 60% të këtij prioriteti.

Ndërkohë vazhdon puna për pastrimin e kanaleve kulluese dhe **kemi një përmbushje të këtij prioriteti në masën 80% në të tre njësitë administrative, por konsiderohet e nevojshme shtimi i koshave të mbeturinave. Mund të themi se ky prioritet është përmbushur në masën 80%.**

Prioriteti nr.4¹⁰ **Biblioteka**

Mungesa e bibliotekës, normalisht që ndikon në jetën e komunitetit në tërësi por mbi të gjitha në jetën e të rinjve, të cilët e kanë kërkuar me ngulm ngritjen e saj.

Prandaj, për sa më sipër kërkohet:

- Planifikimin për ngritjen dhe vënien në efikasitet të një biblioteke e cila duhet ti shërbejë të gjithë komunitetit por mbi të gjitha fëmijëve dhe të rinjve.

Nga takimi i realizuar me Kryetarin e Bashkisë Vau Dejës z. Shkreli, pas marrjes së detyrës rezulton se, ngritja e një biblioteke kërkon shumë investime por me rikonstruksionin e Kinemasë do të shikohet mundësia e krijimit të një biblioteke digjitale.

Përfundim në lidhje me prioritetin nr.4. Ky prioritet nuk është adresuar aspak nga Bashkia Vau Dejës deri në fund të periudhës së monitorimit.

¹⁰ Ky prioritet gjendet vetëm në kontratën sociale të vitit 2021-2023, jo se nuk vazhdon të jetë prioritare për komunitetin kjo problematike por duke marrë përgjigje nga Bashkia në mënyrë të vazhdueshme që është një prioritet që ka nevojë për shumë investime që nuk mund të mbulojnë vetëm nga Bashkia, komuniteti vendosi të kërkojë prioritetet që mund të realizohen me fonde kryesisht të Bashkisë.

Prioriteti nr 5¹¹

Kinemaja

Mungesa e këtij institucioni kulturor ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në jetën e të rinjve në veçanti dhe të komunitetit në përgjithësi.

Prandaj, për sa më sipër kërkohet:

- Rikonstruksion total i kinemasë dhe vënia në gjendje pune duke i rikthyer jetën e saj vitale socio- kulturore.
- Identifikimi i talenteve të reja, promovimi dhe mbështetja e tyre për të ecur përpara dhe për të gjallëruar jetën socio -kulturore

Nga takimi i realizuar me kryetarin aktual të Bashkisë, z. Shkreli, për të diskutuar në lidhje me këtë prioritet rezulton se Bashkia është duke hartuar projektin për rikonstruksionin total të kinemasë dhe që do llojë pranë qeverisë qendrore dhe donatorëve për mbështetje, meqenëse rikonstruksioni total i godinës nuk mund të realizohet vetëm me fonde të Bashkisë.

Përfundim në lidhje me prioritetin nr.5. Nga të gjitha informacionet e marra nga Bashkia dhe komuniteti rezulton se Bashkia nuk ka bërë asgjë vetëm hartimin e projektit për rikonstruksionin total të godinës, prandaj adresimi është në nivelin 20% meqenëse nuk janë gjendur fonde.

Prioriteti nr.6

Infrastruktura Rrugore dhe Ndriçimi ¹²

Normalisht që, mungesa e këtij shërbimi ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek gjithë komuniteti duke penguar lëvizjen e tyre gjatë orëve të natës por mbi të gjitha, ndikon në lëvizjen e grave dhe vajzave sepse nuk ndihen të sigurt natën, e për më tepër, kjo pasiguri shtohet kur rrugët nuk janë të ndricuara.

Prandaj, për sa më sipër kërkohet:

- Bashkia ti kushtojë një vëmendje të veçantë ndriçimit i cili duhet të mbulojë të gjitha lagjet e fshatrave të të gjitha njësive administrative.
- Fshati Mjedë ka nevojë emergjente për ndriçim

¹¹ Ky prioritet gjendet vetëm në kontratën sociale te vitit 2021-2023, jo se nuk vazhdon të jetë prioritare për komunitetin kjo problematike por duke marrë përgjegje nga Bashkia në mënyrë të vazhdueshem që është një prioritet që ka nevojë për shumë investime që nuk mund të mbuloen vetëm nga Bashkia, komuniteti vendosi te kërkojë prioritetet që mund të realizohen me fonde te Bashkië

¹² [file:///C:/Users/User/Downloads/Kontrata-Sociale-Vau-i-Dejes%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/Kontrata-Sociale-Vau-i-Dejes%20(1).pdf), prioriteti nr,6

- Ndriçimi i pedonales së fshatit Hajmel
- Ndriçimi i lagjes Sumaj, Nj.A. Hajmel
- Ndriçimi i fshatit Nenshat.

Kërkohet nga banorët që të bëhet elektrifikim i plotë i fshatit duke qenë se rrjeti i vjetër është shumë i amortizuar dhe për pasojë shkaktohet humbje e madhe në rrjet duke sjellë mosfurnizim të familjeve me energji elektrike.

Gjithashtu në Kontratën Sociale 2023-2027 kërkohet që Bashkia ti kushtojë një vëmendje të veçantë ndriçimit dhe infrastrukturës rrugore konkretisht.

- Ndriçimi i rrugëve dytësore të tre njësive administrative të bashkisë Vau Dejës, njësia administrative Bushat:
- Rikonstruksion i rrugës së Malësorëve
- Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve të brendshme të fshatit Rranxa

Njësia administrative Hajmel:

- Sistemimi i rrugës “Shën Pali – Qershia”
- Mirëmbajtje e rrugës Shelqet – Pistull, vendosje e barrjerave mbrojtëse anës rrugës
- Punime meremetimi urash në njësinë administrative Hajmel
- Sistemimi i rrugës “Dheu i Lehtë”, Pistull

Njësia administrative Vau i Dejës:

- Sistemim, asfaltim dhe ndriçim i rrugës “Pecaj – Shelqet”
- Sistemim, asfaltim i rrugës "Don Nikolli", Laç

Sistemim, asfaltim i rrugës së Komanit, rrugës që lidh rrugën kryesore me Hidrocentralin

Përfundim në lidhje me prioritetin nr.5. Nga monitorimi i kontratës sociale rezulton se kemi një përmirësim të ndriçimit në fshatin Mjedë me vlerë 15,822,134.00 lek, ka përfunduar ndriçimi i pedonales Hajmel, i lagjes Sumaj dhe Nënshat. Po kështu ka përfunduar sistemimi i rrugëve në Rranxa me vlere 15,610,050 lek

Po kështu ka përfunduar sistemi asfaltimi i rrugës “Don Nikolli” rikonstruksion ky që kap vlerën 4,877,985.00 lek dhe është bërë sistemimi i sheshit nga pedonalja deri tek përroi i Tamzës në shumën 3,704,925.00.¹³ Po kështu, kemi ndërtimin e tualeteve publike portative në njësinë administrative Temal në vlerën 1,361,325.00 lek. Gjithashtu po punohet për përfundimin e ndërtimit të unazës së qytetit, në këtë investim do të përfshihen edhe rikualifikimi urban i disa

¹³ <https://www.facebook.com/kristian.shkreli.54/videos/1382719342320606>

rrugëve dytësore te lagjes Kinoklub. Ky investim përfshin vlerën 35 000.000 lek¹⁴. Kryerje e punimeve për sistemim, pastrim të përroit të Glinës me qëllim parandalimin e përmbytjeve¹⁵.
Në përfundim mund të themi se kemi një adresim të këtij prioriteti në masëm 90% në Kontratën Sociale të vitit 2021-2023.

Prioriteti nr.7¹⁶

Shërbime të kujdesit shoqëror për individët në nevojë

Në pjesën më të madhe të familjeve, ngarkesa familjare përballohet vetëm nga gratë, të cilat, krahas përkujdesjes për familjen e ngushtë duhet të kujdesën edhe për të moshuarit. Kjo barrë rëndohet edhe më shumë nëse pjestarë të familjes janë edhe personat me aftësi të kufizuar.

Për sa më sipër kërkohet:

- Bashkia duhet të marrë masa për ngritjen e qendrave komunitare që ofrojnë shërbime për kategori në nevojë; për të rinjtë; gratë viktime të dhunës; të moshuarit etj.

Përfundim në lidhje me prioritetin nr.5 Nga takimi me punonjësit e Bashkisë rezulton se Bashkia është duke punuar për ngritjen e një qendre komunitare multifunksionale për të rinj. Nga ana tjetër rezulton se bashkia ka mbështetur me bonus qeraje 3 familje dhe 114 nga programet e përmirësimit të kushteve të banesës për familjet në nevojë, nga të cilat 7 janë gra kryefamiljare. Ky investim kap vlerën 47,381,552.00 lek. Gjithashtu për familjet në nevojë janë shpërndarë 25 pako ushqimore dhe 37 për fëmijë. Nga ana tjetër, mund të themi se nuk kemi adresim të këtij prioriteti përse i përket ngritjes së Qendrave Komunitare, **prandaj në përfundim të monitorimit të këtij prioriteti mund të themi se ky prioritet është adresuar në masën 50%.**

Prioriteti nr. 8

Programe dhe shërbime të Bashkisë mbi adresimin e dhunës në familje

¹⁴ <https://www.facebook.com/photo/?fbid=6670409876391491&set=pcb.6670419559723856>

<https://www.facebook.com/tv1channelshkoder/videos/231514916626690>

¹⁵ <https://www.facebook.com/photo/?fbid=6662711603827985&set=pcb.6662714577161021>

¹⁶ Prioriteti nr.7 dhe nr.8 i Kontratës Sociale 2021 – 2023 është përmbledhur në prioritetin 2 Drejtësia Sociale në Kontratën Sociale 2023-2027,

Statistikat në këtë bashki evidentojnë faktin se, viktimat e dhunës janë kryesisht gratë, vajzat, si dhe fëmijët. Mungesa e shërbimeve për viktimat e dhunës ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në jetën e grave dhe vajzave. Gjithashtu ato nuk denoncojnë dhunën por vazhdojnë të bashkëjetojnë me të.

Për sa më sipër kërkohet:

- Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje dhe pasojat e saj.
- Rritje e identifikimit të rasteve të dhunës në familje përmes punës proaktive në komunitet të strukturave të shërbimeve sociale.
- Zgjerim i shërbimeve ekzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe ri-integruese për viktimat e dhunës në familje.

Përfundime në lidhje me prioritetin nr.8. Nga monitorimi i bërë ndaj punës së bashkisë për viktimat e dhunës në familje rezulton se Bashkia ka rritur bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile për të ofruara më shumë shërbime për viktimat e dhunës në familje. Krahas bashkëpunimit me Shoqatën “Hapa të Lehtë” dhe “Gruaja tek Gruaja”, ajo ka bashkëpunuar edhe me shoqatën PAPA Giovani XXIII për viktimat e dhunës në lidhje me mundësinë e akomodimit në strehëz dhe Caritas për ofrimin e pakove ushqimore duke zgjeruar në këtë mënyrë zgjerimin e games së shërbimeve për viktimat e dhunës në familje.

Monitorimi i Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës ka 31 anëtarë, Kryetari është burrë dhe njeri nga nën kryetarët është grua. Sekretari është burrë.

Nga 31 anëtarë, 12 janë gra, përfshirë edhe nënkryetaren dhe 19 janë burra.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë realizuar fizikisht në sallën e Këshillit Bashkiak por duke u transmetuar edhe live.


Këshilli Bashkiak Vau Dejës me Vendimin nr. 69, datë 29.09.2023 ka ngritur gjithsej 13 komisione në të cilat;

Komisionet e përhershme:

1. Komisioni i Etikës së Standarteve dhe Apelimeve me anëtarë tre gra.
2. Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurie Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Startegjik të Bashkisë, Mbikqytjes Financiare me anëtarë vetëm burra.

3. Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve, Rekreacionit, Parkingjeve, me anëtarë dy burra dhe një grua.
4. Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizmit dhe Zhvillimit Rural me anëtarë tre gra.
5. Komisioni i Zhvillimit Hapsinor, Infrastrukturës dhe Strehimit, me anëtarë tre burra
6. Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, me anëtarë tre burra.
7. Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Të Drejtave të Njeriut, me anëtarë katër gra.
8. Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me anëtarë dy burra dhe një grua.
9. Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Biodiversiteti me anëtarë dy burra dhe një grua.
10. Komisioni i Arsimit dhe Sporteve me anëtarë dy gra dhe një burrë.
11. Komisioni i Kulturës, Trashigimisë Kulturore, Dhënies së Ttitujve Emërtimeve me anëtarë dy gra dhe një burrë.
12. Komisioni i Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit me anëtarë tre burra.
13. Komisioni për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Integrimin Evropian me anëtarë dy burra dhe një grua.

Këshilli Bashkiak Vau dejës ka ngritur dhe ka funksional 13 komisione. Pjesmarrja e grave në këto komisione është si më poshtë:



Gratë me pozicion Kryetare komisioni përbëjnë 33% të gjithë komisioneve; ndërsa nënkryetare komisioni përbëjnë 40%. Në 27% të komisioneve ato nuk janë as anëtare komisioni.

Nga monitorimi i punës së Këshillit Bashkiak, rezulton se numri i anëtarëve në mbledhjet e Këshillit Bashkiak prezente nga 31 anëtar, numri varion midis 19-20 anëtarë në çdo mbledhje.


Në mbledhjet e Këshillit Bashkiak aktual, konstatojmë që kemi një rënie të pjesmarrjes së anëtarëve në mbledhje, përjashtuar mbledhjet e konstituimit.

Pothuajse të gjitha vendimet merren në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët prezent, dhe vetëm në 10 mbledhje kemi pasur abstenime apo kundërshtime që edhe këto të fundit maksimumi kanë qenë nga një ose dy anëtarë të pranishëm.

Nga monitorimi i vendimeve të Këshilli Bashkiak Vau Dejës rezulton se kemi një numër të konsiderueshëm vendimesh të cilat mund ti konsiderojmë të ndara në këtë format:


- ✓ Vendime me karakter social, që lidhen me mbështetjen financiare për familjet në nevojë, të pastreha, ndihmë të menjëhershme në rast fatkeqësie, bursa, përfshirje në shtëpinë e të moshuarve, mbrojtje civile etj.
- ✓ Vendime me karakter ekonomik ne lidhje me fondin e kushtëzuar,
- ✓ Vendime me karakter procedural që ndikojnë edhe në shërbime.
- ✓ Vendime me ndikim në Infrastrukturë e projekte konstatojmë shumë pak, krahas miratimit të planit të prioriteteve.
- ✓ Nuk konstatojmë vendime me karakter sportiv e arsimor (përveç miratimit të bursave)
- ✓ Vendime në lidhje me dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjoreve, kullotave, në lidhje me nivelin e pagave.

Të paraqitur në formë grafike, puna e realizuar nga Këshilli Bashkiak Vau Dejës Shtator 2022 – Shtator 2023 rezulton si më poshtë:



Nga të gjitha vendimet e marra dominojnë vendimet për dhënien e tokës me qera, konkretisht ato përbëjnë 28% të gjitha vendimeve.

Në vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak Vau Dejës, 22% e tyre kanë pasur direkt lidhje me buxhetin, si rishpërndarja e buxhetit, me realizimin e planit të buxhetit, rishqyrtim i nivelit të taksave dhe gjobave, rishqyrtim i nivelit të pagave, etj.



Vendimet e Këshillit Bashkiak që lidhen me çështjet sociale përbëjnë vetëm 18% ndërsa ato në lidhje me infrastrukturën përbëjnë vetëm 3%.

Në periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023 janë realizuar gjithsej 11 dëgjesa publike¹⁷ ku 4 prej tyre kishin të bënin me buxhetin, një për hapjen e rrugës në fshatin Nënshat dhe 6 për dhënien e tokave me qera.

Përfundime në lidhje me punën e Këshillit Bashkiak.

Nga monitorimi i punës së Këshillit Bashkiak, konstatojmë se jo të gjithë anëtarët marrin pjesë në mbledhje, numri varion 19-20 anëtarë nga 31, vendimet merren me shumicë votash dhe në vetëm pak raste kemi abstenime dhe shumë pak kundështime. Për herë të parë kemi një nënkryetare grua. Kemi një numër të konsiderueshëm të grave si kryetare komisioni, konkretisht 33%. Mbledhjet realizohen fizikisht por transmetohen dhe online.

¹⁷ <https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/>

Vlerësim i thelluar dhe Përfundime

Ajo çfarë mund të prezantojmë në këtë fazë është se Bashkia ka treguar seriozitet dhe angazhim në përmbushjen e prioriteteve dhe ky fakt reflektohet në përmbushjen e 70% të prioriteteve të hartuara në Kontratën Sociale të firmosur në Korrik 2021. Në përfundim të kësaj periudhe monitorimi konstatohet që ka një vëmendje të shtuar jo vetëm në përmirësimin e infrastrukturës, hartimin e projekteve të reja për t'u prezantuar për financim pranë qeverisë por edhe donatorëve, por njëkohësisht edhe ndaj grupeve vulnerabël. Situata duhet vlerësuar në tërësi edhe me fondet që bashkia ka në dispozicion si një bashki e vogël dhe rurale që është. Kemi një rritje të pjesëmarrjes së qytetarëve në forumet publike apo fokus grupe. Shoqata Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë” do të vijojë përsëri monitorimin e punës së Bashkisë, drejtorive përkatëse, si edhe vendimeve të Këshillit Bashkiak pranë kësaj Bashkie, por në vazhdim do të monitorojë Kontratën e re Sociale 2023-2027.¹⁸

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

¹⁸ Kontrata sociale 2023-2027

<https://popnetwork.al/kontrata-sociale-2023-2027-pop-vau-i-dejes/>

Referenca

Faqja zyrtare Bashkia Vau Dejës: <https://www.vaudejes.gov.al/>

Faqja zyrtare Këshilli Bashkiak Vau Dejës: <https://www.vaudejes.gov.al/keshilli-bashkiak/>

Faqja zyrtare në Facebook Bashkia Vau Dejës:
<https://www.facebook.com/profile.php?id=100095183603872>

Faqja zyrtare e Rrjetit POP: <https://popnetwork.al/>

Kontrata Sociale e vitit 2021-2023 [file:///C:/Users/User/Downloads/BASHKIA-VAU-DEJES-Prioritetet-A3-Kontrata-OK%20\(3\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/BASHKIA-VAU-DEJES-Prioritetet-A3-Kontrata-OK%20(3).pdf),

Kontrata Sociale e vitit 2023-2027 [file:///C:/Users/User/Downloads/Kontrata-Sociale-Vau-i-Dejes%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/Kontrata-Sociale-Vau-i-Dejes%20(1).pdf)

Botimi i pare i Monitorimit të Kontratës Sociale 2021-2023: https://popnetwork.al/vau-i-dejes_raporti-monitorues-gusht-dhjetor-2021-kontrata-sociale/

Botimi i dytë i Monitorimit të Kontratës Sociale 2021-2023: https://popnetwork.al/vau-i-dejes_raporti-monitorues-i-kontrates-sociale-2022/

Forum Publik me kandidatin K.Shkreli, nënshkrimi i Kontratës Sociale:
<https://popnetwork.al/8005-2/>

Forum Publik me kandidaten K.Drini, nënshkrimi i Kontratës Sociale;
<https://popnetwork.al/category/aktivitete-vau-dejes/>

Forum Publik me kandidatin Z.Hila, nënshkrimi I Kontratës Sociale: <https://popnetwork.al/pop-forumi-publik-vau-i-dejes-me-kandidatin-e-koalicionit-bashke-fitojme-z-zef-hila/>

Open Data Albania

<https://prokurimettransparente.al/sq/tender/view/id/52829>

<https://prokurimettransparente.al/sq/tender/view/id/52883>

<https://prokurimettransparente.al/sq/tender/view/id/52335>

<https://prokurimettransparente.al/sq/tender/view/id/51507>

<https://prokurimettransparente.al/sq/tender/view/id/51391>

<https://prokurimettransparente.al/sq/tender/view/id/51482>

<https://prokurimettransparente.al/sq/tender/view/id/50908>